



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 612/2024
Datë: 18 qershor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 110 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 18 qershor 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Vendimet e Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me vlerësimet e performancës së prokurorëve publikohen në faqen zyrtare të KPK-së.
2. Përjashtohen nga publikimi në faqet zyrtare informatat të cilat janë në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Obligohet Sekretariati që këtë vendim ta publikoj në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në takimin e mbajtur më 18 qershor 2024, ka shqyrtuar çështjen e publikimit të vendimeve për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve.

Në këtë drejtim, KPK me qëllim që të respektohet parimi i transparencës dhe të mbahet i informuar publiku në lidhje me vlerësimin e punës së prokurorëve të shtetit, por, gjithmonë në pajtim me Ligjin i cili rregullon çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë e individit, me unanimitet vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorë;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së.